



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3, par.1, pika “b”, të Rregullorës mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000, nenit 19 par.1, pika “b”, dhe nenit 40, par. 3, pika II, të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07.06.2005 merr

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT IDEOR PËR TRAJEKTORIN E TRENIT URBAN NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Projekti ideor për trajektorin e trenit urban, në Prishtinë.

Projekti ideor, nga al. 1 e këtij neni, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe ajo grafike, të cilat paraqesin pjesë përbërse të këtij Vendimi.

Neni 2

Projekti ideor, nga neni 1 i këtij Vendimi, është hartuar sipas trajektorit të planifikuar me Planin strategjik- zhvillimi urban i Prishtinës, i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01-031-1231/1, të dt. 02.07.2004.

Neni 3

Projekti ideor, nga neni 1 i këtij Vendimi, do të jetë bazë për hartimin e projekti zbatues për realizimin e ndërtimit të kësaj rruge unazore, si dhe bazë juridike që toka e planifikuar për realizimin e këtij projekti, të shpallet tokë me interes të përgjithshëm shoqëror.

Neni 4

Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve të Komunës së Prishtinës.

Secili Drejtorat i Komunës së Prishtinës do të kryejë veprime nga përgjegjësia e tyre, e caktuar me Statut dhe me rregullativën tjetër ligjore, me qëllim të realizimit të këtij Vendimi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr. 031-13922 dt.14.06.2005

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri